



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1 Përbërja e komisionit

Formohet komisioni për përgaditjen e dokumentacionit për fillimin e procedurës së shpronësimit konform legjislacionit në fuqi për realizimin e projektit për asfaltimin e rrugëve "Mbreti Zog", "Anton Qeta" dhe "Afrim Zhitia" të cilat gjenden në qytetin e Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Ilir Shala , Drejtorati për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë , Kryesues
2. Hanushe Berisha ,DPUMM, anëtare
3. Lumnije Ejupi, Sektori pronësor juridik, anëtare

Neni 2 Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

- Komisioni ka detyrë dhe përgjegjësi të përgadisë dokumentacionin për shpronësimin e rrugëve të cekura më lartë në përputhje me Planet urbane të Komunës dhe të përgadisë formën e Propozim Vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësim konform legjislacionit në fuqi për miratim në seancën e radhës të Kuvendit të Komunjës
- Komisioni detyrat e cekura do ti kryej më së largu brenda afatit 7 ditor (ditë pune) nga dita e pranimit të këtij Vendimi dhe lidhur me këtë duhet t'i raportoj Kryetarit të Komunës.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen, Kryesuesia dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 464-13479
Lipjan, më 09.03.2021

KRYETARI KOMUNËS
Imri Ahmeti

